



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës

Nr. 12.060-7388 dt. 08.02. 2019



Në bazë të nenit 43 pika 43.1 të Ligjit nr.03/L-40 për vetëqeverisje Lokale ,nenit 7 të udhëzimit administrative(MAPL)Nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, Kryesusi i Kuvendit Komunal të Drenasit z.Labinot Halilaj më dt: 08.02.2019 duke filluar në ora 17:30 ne sallën e Kuvendit të Komunës (në objektin e ri) (dite e premte)

Procesverbal i mbledhjes Urgjente

Mbledhja do të ketë këtë :

Rend dite:

1. Rreth dyshimeve për ngacmim dhe abuzim seksual ndaj të miturës.

Drenas,08.02.2019

Prezent gjatë mbledhjes ishin: kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, nënkryetari Gani Sylaj, drejtor të drejtorive komunale, kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj i cili edhe udhëhoqi mbledhjen, asambleistë dhe mediat.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal z. Labinot Halilaj- hapi diskutimin për mbledhjen urgjente e cila filloj në ora 17: 30 min. Ne sot kemi thirrë një mbledhje urgjente për abuzim seksual ndaj të mitures, ne përmes kesaj ngjareje shprehim keqardhje të thellë, ky akt është një akt qyqar, dhe kerkojmë të merren masa ndaj viktimave të tilla. Shpresoj që një rast I tillë most ë përseriet më.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci- “Sikurse gjithë qytetarët e Komunës së Drenasit dhe Kosovës, edhe mua me ka shqetësuar jashtë mase kjo ngjarje. Dua të ju informoj se komuna i ka marr të gjitha veprimet me kohë ndaj mësimdhënësit SH.XH, i cili dyshohet për keqpërdorim seksual ndaj të miturës. Me të marr lajmin në media se është arrestuar një hetues në Stacionin Policor në Drenas, dhe se ky rast lidhet me mësimdhënësin Sh.Xh, menjëherë duke respektuar legjislacionin në fuqi, DKA-ja e ka ripezulluar nga puna mësimdhënësin i cili tashmë është arrestuar nga Inspektorati Policor i Kosovës, ka thënë nder të tjera kryetari Lladrovci dhe ka ftuar edhe një herë organet e drejtësisë që këtë rast të trajtojnë me profesionalizëm të lartë dhe përkushtim, në mënyrë që secili person i implikuar ta marr dënimin e meritua. Ftoj organet e drjetoesisë që të marrin masa lidhur me këtë çeshtje.

Gani Podrimqaku- në emer të PDK-së shprehim keqardhje lidhur me këtë akt të tillë, akte të tilla janë të papranushme, asti I tillë është individual dhe të trajtohet si tillë. Shpresoj që Komuna e Drenasit të jetë rasti i fundit.

Sokol Bylykbashi- Rasti Drenasi na ka tronditur të gjithë, ngase po bëhet fjalë për një vajzë të mitur, e cila sipas raportimeve të mediave është keqperdorur nga sistemi. Ai që do të duhej ta mësonte dhe edukonte e përdhunojë, ai që do të duhej ta mbroj e shantazhoj dhe e kërcenoj për të njejtin qellim, ai që do të duhej ta sheroj e rehabilitojë, ia rrezikoj shëndetin për ta fshehur krimin, kjo ngjarje e rëndë, duhet të na ngris në këmbë të gjithëve për të kërkuar përgjithësi e drejtësi. Unë këkoj doreheqje edhe të Komandantit të stacionit policior duhet të jap doreheqje për shkak se një punetor i tij ka keqperdor asetet dhe ka keqperdor detyrën zyrtare dhe nuk ka arrit me parandalu aktin makaber, gjithashtu kërkoj doreheqje edhe nga Drejtori i Arsimit. Sa i përket asaj se qka mundemi me ndermarrë është shumë e rëndesishme që shkollat gjimnaz dhe teknik të ketë petagog dhe psikolog.

Adem Bucolli- është mirë që mos t’i politizojmë gjerat, të nderuar pasi që kemi degjuar nga mediat qfar ka ndodhë. Me këtë qëndrojmë si individ jo si institucion, ne si qytetar e denojmë fuqishem rastin e tillë, dhasht Zoti të jetë e fundit sepse ne të gjithë I përkasim kesaj shoqërie, e mbi të gjitha pot ë ndodhte në familje qka do të veprojmë!? Besojmë dhe I bejmë thirrje dh eta njoftojme edhe publikun e gjerë që është një krim makaber. Kam një këshillë për prinderit tanë, t’i mesojmë dhe t’i trajtojmë femijet si duhet. Mbes me shpres që ky rast të jetë rasti i fundit dhe shpresoj që mos të ndodhë më.

Petrit Gashi- I nderuar Kryesues,
I nderuar kryetar dhe kabinet i kryetarit
Të nderuar kolegë/kolege

të nderuar të pranishëm,
Rasti i ndodhur i një 16-vjeqare në Drenas, ku u keqtrajtua dhe u abuzua nga një trekëndësh abuzuesish, ka prekur thelle jo vetëm qytetaret e Drenasit, por mbare opinionin publik në Kosove dhe me gjere. Ky raste sikur në ka sjellë në kujtese 20 vite me parë, kur vajzat tona ishin të përdhunara por nga një sistem tjetër dhe nga një dimension tjetër. Raste të tilla të renda, assesi nuk duhet të njollosin komplet institucione qoftë ato policore apo të arsimit dhe tëpërgjithësojnë demin, megjithatë kryesit e veprës kushdo qofshin ata duhet të marrin dënimin e merituar.
Të nderuar koleg/e,

I nderuar kryetar,
Jemi thirrur sot, në një seance urgjente për të diskutuar rreth dyshimeve për ngacmimin dhe abuzim seksual ndaj një të miture vetëm pas iniciativës tonë të një grupi tëasamblistëve për “Seancë të jashtëzakonshme”, dhe pas deklarimeve tëpersonaliteteve më të rëndësishme të shtetit, mediave vendore dhe ndërkombëtarë, mbajtjen e dy protestave e besa edhe të njëseancëe jashtëzakonshme në Kuvendin e Kosovës. Pra, kaq rendësi i keni dhënë këtij rasti sa të fundit diskutojmë për këtë çështje e cila ka renduar shoqërinë tonë dhe e cila na bënëpërgjegjës të gjithë.

Të nderuar të pranishëm,
Nuk ka asgjë me të vështirë se sa sot në këtë foltore të diskutojmë për një rast të tillë, nuk ka asgjë me të vështirë se pasiguria që po mbretëron në në sistemin tonë arsimore dhe të sigurishtë shpërfaqët kaq thelle e kaq keq, ndërkohë që askush nuk merr përgjegjësi edhe pse dikush duhet të mbante përgjegjësi. I nderuar kryetar, Na sollët një material lidhur me mësimdhënësin në shkollë, dhe në atë material kishte vetëm vendim gjykate, nuk kishte një raport nga Këshilli i prindërve, nuk kishte një raport nga këshilli i Shkollës e as një raport nga drejtori i asaj shkollë. Pra për të gjitha këto Drejtoria e Arsimit në Drenas duhet të jap përgjegjësi. Qeverisjet vendosen për të menaxhuar me vendin, me komunën, andaj si kryetar ju është dashur të dini për çdo gjë që ndodhe në arsimin në Drenas. Para 5 apo 6 muaj kur ju nxorët një vendim të paligjshëm për mbylljen e shkollave, nga kjo foltore ju pata paralajmëruar se ju nuk i keni dhënë prioritet arsimit, dhe ju pata paralajmëruar së nëse vazhdoni me këtë gjendje do të përballeni me raste shumë të renda, pra Drejtor i DKA-së, ky është ajo që ju pata paralajmëruar, rasti me i rend që mund të na ndodhte ndonjëherë, dhe nga kjo moskujdesi dhe mos përgjegjësi kërkoj dorëheqjen tuaj.

Të nderuar koleg/kolege,
Me rastin e ndodhur këtu, jam jashtëzakonisht i shqetësuar më nivelin e arsimit në komunën tonë, dhe si prind që jam, po e kam të vështirë të besoj së fëmijën tim të ja dorëzoje një mësimdhënësi të tillë për ta mësuar, ndërkohë që ai mund ta abuzojë e ngacmojë. Pra, këtu edhe me shume është mbjellë pasiguria tek ne, dhe kësisoj ju qeverisja në Drenas mbani përgjegjësi, ju DKA-ja në Drenas mbani përgjegjësi, dhe kjo përgjegjësi nuk duhet kaluar në heshtje dhe sikur nuk ka ndodhur asgjë. Sonte, po diskutojmë për një rast që tanimë ka marr vëmendjen jo vetëm në Kosovë por edhe jashtë saj, por Kryetar ne ende nuk jemi te bindur që nuk ka raste të tjera, dhe këtu lindin shumë pyetje e besa që në asnjërin nuk po e shoh përgjigjen.

Të nderuar të pranishëm,
Si anëtar i kuvendit komunal asnjëherë nuk doja të diskutoja për dukuri të tilla në komunën time, por mbajë peshën dhe përgjegjësinë si të gjithë ju për të luftuar një dukuri të tilla në shoqërinë

tonë, dhe kështu kërkoj nga Drejtori i DKA-së në Drenas që se paku në gjendje morale të jap dorëheqje, se një ngjarje e tillë të kalojë pa jap askush përgjegjësi do të thotë ta ndihmojmë të keqen.

Dashtë zoti që raste të tilla të tmerrshme të abuzimit me të mitur mos të ndodhin askund në botë dhe jo vetëm në Drenas, në Kosovë, dhe ata që kanë kryer këtë krim le të marrin dënimin e merituar. Thërras organet e drejtësisë që sa më shpejt të zbardhin të vërtetën ndërsa qeverisjes në Drenas bëjë thirrje që të vendosin si prioritet arsimin dhe sigurinë neper shkollë. Faleminderit!

Petrit Sinani- askush prej neve nuk do të donte t'i përkiste një shoqërie, ku mëngjesi do të qilte nën abuzimin e një mesuesi, mesdita në kthetirat e policit, kurse mbremja në briskun e mjekut. I ftoj të gjitha organet kompetente ta zbardhin këtë rast, askush prej neve nuk do të donte këtë gjë. Shpresoj që ky rast të jetë rasti i fundit.

Sabrije Kukaj- Rasti në fjalë na ka prek të gjithëve si shoqëri, dhe jo vetëm në Komunën e Drenasit, dhe fajin e kemi të gjithë ne si shoqëri se si nuk e kemi mundur me parandalu një gjë të tillë, të marrim masa t'i ndajomë këto dhe të ndertojmë mekanizma të i vetëdijeshmë nxenesit që most e bëjnë pre e njereve të tillë, sepse ka njëzë të pandërgjegjshme, dhe ka krimba që po mundohen që me I krimb të gjithë si shoqëri. Shpresoj që kjo të jetë rasti i fundit dhe mos të përsëritet më.

Beqir Kiqina- të nderuar! Tani jemi në disa momente të vështira, që nga pas lufta sot po kujtohen disa gjëra të trishta që nga paslufta. Ditëve të fundit jemi të trishtuar nga rasti i të miturës që është abuzuar nga arsimi, drejtësia dhe mjekësia. Në këtë seancë të jashtëzakonshme do të diskutojmë për këtë çështje, ku do të kërkohej që drejtorët e shkollave të raportojnë më shpesh se paku qdo 6 muaj rreth rezultateve të mesimdhënesve, mungesave dhe problemet e nxenesve, si dhe të jenë të njoftuar familjare. Shpresoj që sot të merret një vendim ku do të kërkohej llogaridhënia e përfaqësuesve të institucioneve arsimore.

Uroj që Kuvendi Komunal të ndërmerr masa që kështu lloj ngjarjesh që e kanë tronditur opinionin të mos ndodhin sërish.

Florentina Elezi- Përsëritet, Më vjen keq që jemi mbledhur sot këtu për një rast kaq të tmerrshëm! Por në anën tjetër, ndoshta ka diçka të mirë këtu, sepse ky është njëri nga shumë raste tjera, që ju ndodh vajzave në këtë vend, e që nuk kanë guxim ta ngrisin zërin, sepse siç edhe e pamë zëri i tyre po u bëka vuajtje, përdhunim e kërcënim!! Ky rast duhet të na bëjë të gjithëve më të përgjegjshëm në punën që e bëjmë, vetëm pse jemi në një pozitë, mos ta keqpërdorim për gjëra kaq të ndyra dhe irrituese. Nuk jam duke e politizuar rastin, as që dua të fitoj ndonjë pikë politike mbi raste të tilla, ta lëmë politiken anash, por t'flasim mbi të gjitha si njerëz, njerëz me mendje të shëndoshë. Dua të i kërkoj që të dorëhiqen, sepse kanë dështuar, drejtori i Arsimit po ashtu edhe drejtori i gjimnazit, kanë dështuar të gjithë me këtë rast sepse nuk është diçka që ka ndodhur 1 muaj apo 2, rast që ka ndodhur me vite. ... mua po më shqetëson edhe një fakt! si bëhet që një mësuese (ish drejtoreshë e shkollës) të suspendohet nga puna dhe të përjashtohet për


një incident të vogël ndaj një nga nxënësit më problematik, kurse tjetri që ka bërë një vepër të tillë të kthehet kaq lehtë në punë... ky është shqetësimi im... Standardet e dyfishta në këtë vend, kush ka njerëz t'polikes shpëton e kush jo për gjënë më të vogël përjashtohet, fyhet, nënçmohet... Unë kam besim ende në arsim dhe policinë e Kosovë, hiç më larg se sot pash lot nga polici i cili ishte i mërzhitur e i trishtuar si të gjithë ne, pash mesimdhenës që ju bashkangjitën protestes , unë e di që kemi njerëz shumë të mirë. Por, duhet të reagojmë sa më shpejtë që t'i largojmë ata që nuk janë kompetent për punën që e bëjnë, që nuk i meritojnë ato vende të shenjëta, sepse në këtë formë i mbrojmë të mirët dhe meritoret. Ju faleminderit!

Fitore Morina- rasti i profesorit, i të mitures, rast ky që mori bujë, na ka prek të gjithëve , rast ky që vend të mbrojtjes mori dhunimin, a është ky rast i izuluar apo ka edhe raste të tilla Brenda shkollave tjera në Kosovë. Përgjithësia bëj direct tek Drejtori I Arsimit. Kërkoj nga Drejtori I DKA-së dhe Drejtori I shkolles të japin doreheqje. E denojmë ashper këtë veper, dhe shpresojmë që të mos përsëritet më, dhe të jetë ky rasti i fundit.

Mbledhja përfundoj rreth orës 18:30 min.

08.02.2019

Procesmbajttese:


Liridona Fejza Ajazi

